



5074/24 30 SEP 2024


## KOMUNA E GRAÇANICËS

Në bazë të nenit 8 paragrafi 3 pika 2 të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, Komuna e Graçanicës, më datën 30.09.2024, shpall këtë:


### THIRRJE PUBLIKE

#### për përzgjedhjen e 2 përfaqësuesve të Komisionit Vlerësues nga grupi i ekspertëve të jashtëm

1. Ftohen individët e interesuar dhe përfaqësuesit e organizatave joqeveritare (OJQ) që të paraqesin Aplikacion për përzgjedhjen e anëtarit të Komisionit Vlerësues të ofertave të dorëzuara sipas Thirrjes publike për mbështetjen financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve me qëllim të zbatimit të masave mbështetëse për qytetarët në situatë të vështirë materiale
2. Kandidatët duhet të kenë përvojë shumëvjeçare në punën e organizatave joqeveritare ose agjencive të pavarura dhe të mos jenë të dënuar për vepra penale.
3. Kandidatët e përzgjedhur do ta kryejnë detyrën e anëtarit të Komisionit vlerësues pa kompensim në përputhje me dispozitat e Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
4. Afati për paraqitjen e Aplikacionit është prej datës 01.10.2024 deri më 09.10.2024.
5. Të bashkëngjitur me Aplikacion ju duhet të dorëzoni edhe një biografi të shkurtër me të dhënat mbi përvojën e punës.
6. Aplikacionet mund të dorëzohen përmes postës ose personalisht në këtë adresë: *Komuna e Graçanicës, rruga "Car Lazar" pn 10500 Graçanicë.*



Kryetarja e komunës

  
Prof.dr. Ljiljana Šbarić